



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIJËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJËS**

Nr. 791/11 Prot.

Tiranë, më 16.02.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1550, datë 06.01.2012.

**SHOQËRISË “KRISTI-KONSTRUKSION” SH.P.K**  
**Lagjia “Pavarësia”, Rr. Sadik Zotaj, Qendra tregtare “Riviera”, Kati i 2, Vlorë**

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
**Bloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA**  
**Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “KRISTI-KONSTRUKSION” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1550, datë 06.01.2012, për mineralin Gur gëlqeror, në objektin “Fshati Radhimë”, qarku Vlorë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.465, datë 25.01.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.791, Prot, datë 26.01.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1550, datë 06.01.2012, për mineralin Gur gëlqeror, në objektin “Fshati Radhimë”, qarku Vlorë pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit për vitin 2020 dhe 2021.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1550, datë 06.01.2012, për mineralin Gur gëlqeror, në objektin “Fshati Radhimë”, qarku Vlorë që shoqëria Juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1550, datë 06.01.2012, për mineralin Gur gëlqeror, në objektin “Fshati Radhimë”, qarku Vlorë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**

**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

